



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MEMALIAJ
NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 2047 Prot

Memaliaj më, 15 / 09 / 2025

Lënda: **Kërkesë për publikim vëndesh të lira**

ZYRËS VENDORE TË PUNËSIMIT
TEPELENË

Bashkia Memaliaj, ka vendosur të shpallë procedurën e konkurimit për pozicionin, “*Drejtor në Drejtorinë e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës*”.

Për këtë arsye, në përputhje me Ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në bazë e në zbatim të tij, kërkojmë publikimin e pozicionit të lirë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Bashkëlidhur do të gjeni kërkesën përkatëse për publikim.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,


KRYETARI
Albert MALAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MEMALIAJ

Nr. 2021 Prot

Memaliaj më, 15 / 09 / 2025

**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVIL,
LËVIZJE PARALELE DHE PËR NGRITJEN NË DETYRË**

Drejtore në Drejtorinë e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës
Kategoria e pagës II-2

Në zbatim të nenit 26 të Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit Nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Memaliaj shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin:

- Drejtore në Drejtorinë e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës.
 - Kategoria e pagës II-2.

Plotësimi i pozicionit më sipër bëhet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë. Të dyja këto procedura është vendosur të jenë të hapura edhe për kandidatë të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin e lire (në zbatim të nenit 26/4).

Për të dy Procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë)

aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e Dokumenteve: 30.09.2025

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Drejtor në Drejtorinë e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës - Kategoria e pagës II-2

- Harton nga ana teknike projekte dhe plane për ndërhyrje në rehabilitimin e infrastrukturës dhe ndërtimin e veprave të reja publike.
- Merr pjesë në identifikimin e projekteve prioritare, të cilat do të financohen nga buxheti I bashkisë ose burime të tjera të financimit publik.
- Merr pjesë në proceset e prokurimit të secilit investim nëpërmjet ekspertizës teknike.
- Monitoron zbatimin e kontratave për punimet, shërbimet, blerjet, etj. të kryera me fonde të bashkisë ose fonde të tjera.
- Merr pjesë në përgatitjen e evidencave për zbatimin e mirëmbajtjes ose investimeve për secilin ndërtim.
- Hedh të dhënat teknike në bilanci përkatës të punimeve publike.
- Plotëson regjistrin e vizitave periodike në terren lidhur me veprimet e ndërmarra ndaj problemeve të evidentuara gjatë mbikëqyrjes, rëlvimeve, matjeve, përpunimit të të dhënave dhe interpretimit të tyre bazuar në datat, ngjarjet gjatë ndërtimit, etj.
- Harton një raport në fund të çdo muaji për të gjitha kontrollet e ushtruara duke i vendosur të dhënat në dispozicion të Kryetarit të Bashkisë.
- Përgatit informacionin bazë për të gjitha kërkesat nga qytetarë, biznese ose ente publike drejtuar bashkisë për leje ndërtimi.
- Siguron që kërkesat të jenë në përputhje me Planifikimin Urban Territorial të Bashkisë.
- Shërben si sekretariat teknik pranë komitetit bashkiak për miratimin e lejeve të ndërtimit

DETYRAT KRYESORE

- Përgatit materialet për studimet në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorial brenda juridiksionit të bashkisë
- Drejton punën për hartimin e projektit të planit rajonal, planit rregullues sipas planeve të zhvillimit të territorit.
- Kryen funksionet e sekretarisë teknike të KRRT-së.
- I propozon Kryetarit të Bashkisë masat për zgjidhejen e kërkesave të qytetarëve, në përputhje me ktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Harton projekte dhe preventive për investimet që parashikohen të kryhen nga Bashkia
- Përcakton vlerësimin e trualit pronë shtetërore mbi të cilin do të kryhet ndërtimi
- Mban dhe sistemon dokumentacionin e zhvillimit të tenderave dhe pas përfundimit të tyre dorzon dokumentacionin në arkivën e bashkisë.
- Kryen inspektimin e situatës në vend rast pas rasti. Hartimi i dokumentit të analizës dhe verësimit të gjendjes ekzistuese territorial në territorin e njësisë së qeverisjes venodpre i cili shoqërohet me paraqitje grafike .
- Hartimi I planit të propozuar për përdorimin e tokës
- Hartimi i dokumentit për prezantim të planit të përgjithshëm vendor në Këshillin Bashkiak
- Hartimi i rregullores vendore të planifikimit
- Hartimi irregulores vendore të kontrollit të zhvillimit
- Shqyrtimi i kërkesave të lejeve të punimeve nga KKT në në fazën e vlersimit të përmbushjes

- së formës duke hartuar një raport ku shprehet vlerësimi nëse për këtë kërkesë nevojitet Planit I detajuar vendor ose jo dhe raporti I përcillet AKPT
- Realizon procesin e ndarjes së parcelave apo bashkimit të tyre si pjesë përbërse e planit të detajuar vendor dhe që është subject miratimi nga Këshilli Bashkiak
 - Ndjekja e procedurave për miratimin e Planit të detajuar vendor
 - Menaxhimi i sistemit elektronik të e-leje Albania në lidhje me planifikimin dhe shqyrtimin teknik të kërkesave për leje zhvillimi, leje ndërtimi, leje ifrastrukturore, certifikatë përdorimi, ndryshime të projektit gjatë zbatimit të punimeve, ndryshim të subjektit zbatues etj.
 - Përpilim i analizës së çmimeve të preventivave të objekteve të projektuara
 - Ndjekja vazhdimisht në terrën e procesit të zbatimit të projekteve, duke sqaruar dhe dhënë zgjidhje teknike problemeve që dalin gjatë realizimit të projektit
 - Ndjekja vazhdimisht në terren e procesit të zbatimit të projekteve, duke sqaruar dhe dhënë zgjidhje teknike problemeve që dalin gjatë realizimit të projektit
 - Ndjekja e projekteve të propozuara .
 - Zhvillimi i vendimeve të KKT-së për miratimin e zonave të Urbanizuara
 - Hartimi dhe ndjekja me përparsi e programit të studimeve dhe zhvillimit urban të territorit.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria II-2);
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor”, edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë shkenca inxhinierike. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit,*

Adresa: Bashkia Memaliaj, Rruga “Tafil Buzi” godina nr 7- Kodi Postar 6302 Tel&Fax : _____ e-mail: info@bashkiamemaliaj.gov.al

duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).

- b) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vite , në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura etj.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupe.
- d) Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 30.09..2025 .

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 03.10 .2025,) njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkia Memaliaj ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike". Njohuritë mbi Ligjin Nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".
- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin epunimeve të ndërtimit" i ndryshuar dhe aktet nëligjore në zbatim të tij.
- d) Njohuritë mbi VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedures së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur", të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://dap.gov.al).

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit

2

NGRITJA NË DETYRË

*Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë,
Kjo procedurë është vendosur të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin e lire (në zbatim të vendimit të titullarit por që nuk mund të kalojë 20% të numrit total të vendeve në cdo vit kalendarik, neni 26/4).*

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;
- d- Niveli i diplomës duhet të jetë “Master Shkencor”. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon: Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë shkenca inxhnierike. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).

- a) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vite, në administratën shtetërore dhe/ose në institucione të pavarura etj.
- b) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- c) Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

2.2

DOKUMENTECIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

Adresa: Bashkia Memaliaj, Rruga “Tafil Buzi” godina nr 7- Kodi Postar 6302 Tel&Fax : _____ e-mail: info@bashkiamemaliaj.gov.al

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 30.09.2025, në Bashkinë Memaliaj.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 03.10.2025, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkia Memaliaj, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.
- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” I ndryshuar dhe aktet nëligjore në zbatim të tij.
- d) Njohuritë mbi VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur", të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://dap.gov.al).


<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Memaliaj do të shpallë fituesin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit". Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

NJËSIA PËRGJEGJËSE E BURIMEVE NJERËZORE

BASHKIA MEMALIAJ



Adresa: Bashkia Memaliaj, Rruga "Tafil Buzi" godina nr 7- Kodi Postar 6302 Tel&Fax : _____ e-mail: info@bashkiamemaliaj.gov.al